



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:078090  
Datë: 25.06.2024  
Numri i dokumentit: 05855430

C.nr.1127/24

**PROCESVERBAL I SEANCËS PËRGATITORE**  
**I përpiluar më 21.06.2024, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë**

**Gjyqtari:**  
Leart Rexhaj

**Paditësi:** M.K-A  
**E paditura:** U.M-I.B

**Procesmbajtësi:**  
Valdete Sadiku

**Lënda e kontestit:** Kompensim i shujtës ushqimore.

Filloj në 11:45  
Seanca është publike

Gjykata njofton palët se në kuptim të nenit 116 të LPK-së, kanë për detyrë që për çdo ndërrim eventual të adresës ta njoftojnë gjykatën menjëherë, në të kundërtën dërgimet e mëtutjeshme të shkresave do të bëhen me anë të afishimit të tyre në tabelën e shpalljeve në gjykatë

Gjyqtari e hapë shqyrtimin, e publikon lëndën e shqyrtimit dhe konstaton, se në seancën përgatitore janë të pranishëm:

**Për paditësin:** Av.L.A, sipas autorizimit me shkrim në shkresat e lëndës.

**Për të paditurën:** V.S, juriste pranë të paditurës, sipas autorizimit me shkrim në shkresat e lëndës.

Gjykata bie këtë:

**A K T V E N D I M**

Mbahet seanca e sotme e cila është verbale dhe publike.

Palët njëzëri i propozojnë gjykatës që të aprovojë këtë:

## **PAJTIM GJYQËSOR**

**DETYROHET** e paditura U.M-I.B, që paditësit M.K-A ne emër të kompensimit për shujtën ushqimore për ditët e pranisë në punë për periudhën 21.01.2021 – 22.11.2022, për 124 ditë, t’ia paguajë shumën prej 248.00 Euro, si dhe shpenzimet e procedurës dhe atë, për padi 78.00 Euro, për mbajtjen e seancës shumën prej 101.00 Euro, dhe 21.00 Euro për taksë, në afat prej 7 ditësh nga dita e sotme, në llogarinë bankare të av. Sh.A B.I, me nr.....në BPB.

I autorizuari i paditësit:

E autorizuar e të paditurës:

Pas kësaj Gjykata merr këtë:

### **A K T V E N D I M**

**APROVOHET** në tërësi pajtimi gjyqësor i lartëproponuar i palëve ndërgjyqësore.

Ky pajtim gjyqësor paraqet titull përmbarimor.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Lënda të arkivohet si e kryer.

Përfundoi në ora 11:55.

Palët prezentë nënshkruajnë këtë procesverbal pa vërejtje.

I autorizuari i paditësit:

E autorizuar e të paditurës:

### **V ë r t e t o j n ë:**

Procesmbajtësi:

Gjyqtari: